



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.329/2020

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit M.M., për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogovc P.nr.101/2020 të datës 19.05.2020 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.695/2020 të datës 06.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08 dhjetor 2020, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit M.M. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogovc P.nr.101/2020 të datës 19.05.2020 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.695/2020 të datës 06.10.2020.

### A r s y e t i m

#### **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogovc, me aktgjykimin P.nr.101/2020 të datës 19.05.2020, e ka shpallur fajtor të dënuarin M.M. për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe e ka gjykuar, me dënim burgimi në

kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 400 (katërqind) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 23.04.2020 deri me datë 19.05.2020. I dënuari është obliguar në pagesën prej 20 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, shumë prej 30 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumë prej 30€, në fondin e kompensimit të viktimave të krimit, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr. 695/2020 të datës 06.10.2020, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësit të të dënuarit dhe të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit M.M. av. A.M. nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe dënimin me burgim efektiv ta shndërroj me dënim me kusht apo t'i anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

### **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.181/2020 e datës 26.11.2020, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit, thekson se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj nuk ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese të cilat janë të përcaktuara me dispozitat e Kodit Penal dhe atë rrethanën lehtësuese personale se i dënuari kujdeset për motrën e tij F.M. e cila është e prekur me sindromin down si dhe gjendjen e rëndë ekonomike. Po ashtu në rastin konkret tek i dënuari nuk janë marrë parasysh rrethanat tjera lehtësuese se më parë nuk ka qenë i dënuar dhe përmes punës në ndërtimtari siguron të ardhura për familjen e tij. Rrethanat lehtësuese të

cekura më lartë nuk janë marrë parasysh as nga gjykata e shkallës së dytë por e njëjta i ka refuzuar si të pabazuara pretendimet e paraqitura në ankesë, meqë po të merreshin parasysh këto pretendime do të paraqisnin arsye për shqiptimin e dënimit të kushtëzuar ndaj të dënuarit.

Më tutje pretendohet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë nga përbërja e kolegjit i cili nuk ishte formuar në pajtim me ligjin pasi që në marrjen e aktgjykimit në gjykatën e shkallës së dytë në cilësi të kryetarit të kolegjit ka marrë pjesë gjyqtari Hashim Qollaku i cili ka vendosur gjithashtu si anëtar i kolegjit në procedurën paraprake sipas ankesës kundër aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit sipas lëndës PN1.DP.nr.392/2020 të datës 29.04.2020. Në këtë mënyrë pretendohet se është vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 par.2 të KPPK-së, meqë rezulton se në shqyrtimin e ankesës ka marrë pjesë gjyqtari i cili ka qenë dashur të përjashtohen pasi që përbërja e kolegjit në gjykatën e shkallës së dytë nuk ka qenë në pajtim me ligjin dhe kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave ka parashtruar kërkesë, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Pretendimi përkitazi me përbërjen e kolegjit penal të gjykatës së shkallës së dytë, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, del të jetë i pabazuar, përkundër asaj se qëndron fakti se në përbërjen e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë ka marrë pjesë gjyqtari i cili ka vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe i cili po ashtu paraprakisht ka marrë pjesë edhe në shqyrtimin e ankesës për shkak të caktimit të masës së paraburgimit ndaj të dënuarit. Megjithatë me këtë nuk është shkelur

dispozita e nenit 39 par.2 të KPPK-së, meqë në rastin konkret anëtari i kolegjit penal të gjykatës së shkallës së dytë nuk ka vendosur për caktimin e masës së paraburgimit por ka vendosur përkitazi me ankesën për caktimin e kësaj mase, andaj, kjo nuk paraqet bazë për përjashtimin e gjyqtarit me rastin e vendosjes sipas ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Duke vlerësuar pretendimet e theksuara përkitazi me shkeljen e ligjit penal, përkatësisht faktin se gjykatat e dy instancave më të ulëta me rastin e shqiptimit të dënimit nuk kanë marrë parasysh rrethanat lehtësuese, Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoj se të dy gjykatat respektive në mënyrë të drejtë kanë zbatuar ligjin penal dhe të dënuarit i kanë shqiptuar dënimin e përcaktuar brenda kornizave të minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar dhe bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPPK. Kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore. Andaj, në rastin konkret drejt është aplikuar ligji penal, ashtu që pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit i paraqitur në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar, dhe për më tepër, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore, dhe arsytet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.329/2020, më 08 dhjetor 2020

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka